

KONTRATË THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“A&N” shpk

Sot me datë 20.10.2020, në Gjirokastrë, me vullnetin tonë të lirë, ne të nënshkruarit:

- Armando GURI, i biri i Naim, i datëlindjes 11 Janar 1977, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Manalat i I^{rë} Gjirokastrë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H70111064I me datë lëshimi 21/03/2019
- Nermin PULA, e bija e Ismail, e datëlindjes 30 Prill 1971, lindur në Tiranë dhe banuese në Rruga “Muhamet Gjollësia”, Pallati 67/6, Shk.2, Ap.16, Tiranë, mbajtëse e pasaportës me numër BB6023115 dhe numër personal H15430064B me datë lëshimi 01/06/2012.

ne zbatim të Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare të Regjistrimit”,

Neni 1

Vendosa të themeloj shoqërine me përgjegjësi të kufizuar **“A&N” shpk.**

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Tregëti me shumicë dhe pakicë e mallrave ushqimore, industriale, bujqësore e blegtorale
- Import-Export mallrave ushqimore, industriale, bujqësore e blegtorale
- Shërbime ndërmjetësimi për shitjen e mallrave dhe shërbimeve të tjetër
- Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit.

Neni 3

Ortakët themelues të shoqërisë janë: z.Armando GURI dhe znj. Nermin PULA.


Neni 4


Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të organeve drejtuese të kësaj shoqërie.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 100,000 lekë (njëqindmijë) dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota, e ndarë si më poshtë:

1. Armando GURI, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50% të kapitalit themeltar
2. Nermin PULA, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50% të kapitalit themeltar

Armando Guri


Nermin Pula


Neni 6

Selia e shoqërisë është Lagja Zinxhira, Rruga “Çelo Sinani”, objekti nr. 09 Gjirokastrë.

Neni 7

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar në kohë dhe fillon që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 8

Administrator i shoqërisë është z. Armando GURI, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë për 5 vite, me të drejtë rizgjedhje dhe është i ngarkuar të kryejë akte dhe të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 9

Personaliteti juridik i shoqërisë fitohet me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Aktiviteti i saj do të fillojë pas kryerjes së procedurave ligjore. Në aktivitetin e shoqërisë do të përmbahemi statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj legjislacionin në fuqi. Kjo kontratë themelimi u redaktua në katër kopje, me vlerë të njëjtë ligjore, një kopje dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, një kopje dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe nga një kopje ortakëve themelues të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË “A&N” shpk.

Armando GURI _____.

Nermin PULA _____.